



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E HARTIMIT TË AKTEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE**

Nr. 2644 Prot.

Tiranë, më 12.09.2023

URDHËR

Nr. 94 Dt. 12. 09. 2023

“PËR

**MARRJEN E INFORMACIONIT PERIODIK NGA KRYETARET E
GJYKATAVE DHE DREJTUESIT E PROKURORIVE LIDHUR ME
VEPRIMTARINË GJYQËSORE DHE VEPRIMTARINË E PROKURORIVE”**

Në mbështetje të nenit 204, pika 1, shkronjat “b” dhe “k”, nenit 194 dhe 216 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 106, pika 1, të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në funksion të përmbushjes së veprimtarisë kushtetuese dhe ligjore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjatë kryerjes së hetimeve disiplinore dhe inspektimeve institucionale e tematike, janë hasur mungesa të informacioneve në kohë reale dhe të vazhdueshme, mbi gjendjen e faktike të volumit të punës, caktimit të çështjeve, kërkesat për heqje dorë, respektimi i afateve procedurale apo problematikat e ndryshme të raportuara nga gjykatat dhe prokuroritë.

Mungesa e aksesit në sistemin elektronik të teknologjisë së informacionit për organet e sistemit të drejtësisë, për gjenerimin e raporteve statistikore dhe analitike, në aspekte të rëndësishme të miradministrimit të sistemit gjyqësor dhe të prokurorive, vështirëson ushtrimin e mekanizmave të monitorimit nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në respektim të parimit të ligjshmërisë, deburokratizimit, efijencës, me qëllim zhvillimin e një mekanizmi për të përcaktuar politikat institucionale në fushën e inspektimeve, vlerësohet e domosdoshme marrja e informacioneve të vazhdueshme e periodike, që do t'i shërbejnë përmirësimit të monitorimit nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të problematikave me të cilat përballlet sistemi gjyqësor dhe zyrat e prokurorive.

Për këto arsye,

V E N D O S A:

1. Marrjen e informacioneve periodike nga kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorive të të gjitha gjykatave dhe prokurorive në Republikën e Shqipërisë, si vijon:

1.1. Nga kryetarët e gjykatave:

- a) volumin e përgjithshëm të çështjeve gjyqësore për gjykatën dhe për çdo gjyqtar që ushtron veprimtarinë pranë asaj gjykate, duke përcaktuar numrin e çështjeve të reja, numrin e çështjeve të mbartura nga vitet paraardhëse, numri total i çështjeve në gjykim;
- b) numrin e çështjeve tej afateve të arsyeshme të parashikuara në nenin 399/2 të Kodit të Procedurës Civile, për të çdo shkallë gjykimi;
- c) respektimin e etikës dhe solemnitetit në seancë nga trupa gjyqësore;
- d) numrin e kërkesave për heqje dorë nga gjykimi si dhe numrin e vendimeve të miratuara për heqje dorë, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin procedural, penal, civil dhe administrativ;
- e) numrin e kërkesave për përjashtim gjyqtari me kërkesë të palëve dhe numrin e vendimeve për pranim të kërkesave për përjashtimin e gjyqtarit, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin procedural, penal, civil dhe administrativ.
- f) funksionimin e sistemit të regjistrimit audio dhe përdorimin e tij nga secili prej gjyqtarëve, duke evidentuar numrin e seancave gjyqësore të regjistruara dhe të paregjistruara në këtë sistem;
- g) gjendjen e funksionimit dhe përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, së bashku me nevojat e konstatuara për përditësimin e këtij sistemi;
- h) numrin e vendimeve të arsyetuara dhe dorëzuara përtej afateve sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin procedural penal, civil dhe administrativ, sipas llojit të çështjes;
- i) problematikat e tjera të evidentuara nga gjyqtarët apo kryetari i gjykatës.

1.2. Nga drejtuesit e zyrave të prokurorive;

- a) volumin e përgjithshëm të çështjeve për prokurorinë dhe për çdo prokuror që ushtron veprimtarinë pranë asaj prokurorie, duke evidentuar numrin e çështjeve të reja, numrin e çështjeve të mbartura nga vitet paraardhëse, numri total i çështjeve në hetim, përfshirë edhe ato çështje për të cilat nuk është regjistruar emri i personit që i atribuohet vepra penale (pa autor) ;
- b) numrin e çështjeve në hetim për të cilat është zgjatur afati i hetimit sipas parashikimeve të nenit 324, të Kodit të Procedurës Penale (nga momenti kur është regjistruar emri i personit që i atribuohet vepra penale dhe është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale;
- c) respektimin e disiplinës dhe etikës nga prokurorët;
- d) numrin e kërkesave për heqje dorë, sipas nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale dhe numrin e vendimeve për pranim të kërkesës për heqje dorë të drejtuesit të

- prokurorisë sipas parashikimeve të nenit 26, pika 2 dhe pika 3, të Kodit të Procedurës Penale;
- e) numri i kërkesave për zëvendësim të prokurorit sipas nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale dhe numri i vendimeve për praninë të kërkesës për zëvendësim të drejtuesit të prokurorisë, sipas parashikimeve të nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale;
 - f) gjendjen e funksionimit dhe përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, së bashku me nevojat e konstatuara për përditësimin e këtij sistemi;
 - g) numri i kërkesave dhe vendimeve për zgjatjen e afateve të paraburgimit;
 - h) numrin e rasteve të shtyrjes së seancave gjyqësore për shkak të mungesës së prokurorit;
 - i) çdo problematikë tjetër të evidentuar nga prokurorët apo drejtuesi i prokurorisë.
2. Informacioni i parashikuar në pikën 1.1. dhe pikën 1.2. të këtij urdhri kërkohet mbi baza tre mujore, sipas formularëve të aneksit nr. 1 dhe aneksit nr. 2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij urdhri, për periudhat:
- a) Janar-Qershor;
 - b) Korrik-Dhjetor.
3. Kërkesa për marrjen e informacionit i dërgohet në formë shkresore dhe në rrugë elektronike nëpërmjet adresës zyrtare të postës elektronike të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: info@ild.al, gjykatave dhe zyrave të prokurorive në Republikën e Shqipërisë.
4. Informacioni i kërkuar duhet të përcillet nga autoritetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri, duke filluar nga data 30 shtator 2023, për periudhën janar - qershor 2023 dhe brenda datës 10 të muajit pasardhës, referuar periudhave të raportimit.
5. Informacioni i marrë nga kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorive, përpunohet Drejtoria e Analizës dhe Standardeve dhe Drejtoria e Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike, sipas funksioneve të tyre. Informacioni i përpunuar brenda 5 ditëve, i përcillet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për shqyrtim dhe vlerësim të mëtejshëm.
6. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për publikimin e këtij urdhri në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORLI LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani

**RAPORTIMI PERIODIK
(6- mujor)**

GJYKATA	
Gjashtëmujori i raportimit	
Kryetari i Gjykatës (emër, mbiemër, e-mail, tel)	
Personi përgjegjës për përgatitjen e raportit (emër, mbiemër, e-mail, tel)	
Data e raportimit	

A. VOLUMI I PËRGJITHSHËM I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE PËR ÇDO GJYQTAR

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të reja të regjistruara për periudhën e raportimit	Nr. çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme	Nr. çështjeve total në gjykim
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				

B. NUMRI I ÇËSHTJEVE TEJ AFATEVE TË ARSYESHME

Nr	Gjyqtari	Nr. i çështjeve tej afateve të arsyeshme
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		

C. RESPEKTIMI I ETIKËS DHE SOLEMNITETIT NGA ANA E TRUPËS GJYQËSORE

Përshkrim të rasteve për respektimin e etikës dhe solemnitetit nga trupa gjyqësore

D. NUMRI I KËRKESAVE PËR HEQJE DORË NGA GJYKIMI

Nr.	Gjyqtari	Nr. i kërkesave për heqje dorë nga gjykimi	Numri i kërkesave të pranuar për heqje dorë nga gjykimi
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			

E. NUMRI I KËRKESAVE PËR PËRJASHTIM GJYQTARI

Nr.	Gjyqtari	Nr. i kërkesave për përjashtim gjyqtari	Nr. i kërkesave të pranuar për përjashtim gjyqtari
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			

F. FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË REGJISTRIMIT AUDIO

Nr.	Gjyqtari	Nr. i seanca gjyqësore të regjistruara audio	Nr. i seanca gjyqësore të pa regjistruara audio
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			

G. GJENDJEN E FUNKSIONIMIT DHE PËRDORIMIT TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË ÇËSHJTEVE SË BASHKU ME NEVOJAT E KONSTATUARA PËR PËRDITËSIMIN E KËTIJ SISTEMI

Përshkrim i shkurtër mbi gjendjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve së bashku me nevojat e konstatuara për përditësimin e këtij sistemi

H. NUMRI I VENDIMEVE TË ARSYETUARA DHE DORËZUARA PËRTEJ AFATEVE

Nr.	Gjyqtari	Numri i vendimeve të shpallura për periudhën	Numri i vendimeve të dorëzuara me vonesë
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			

I. PROBLEMATIKË TJETËR E EVIDENTUAR

Përshkruani çdo problematikë tjetër të evidentuar gjatë periudhës së raportimit që lidhet me veprimtarinë gjyqësore.

**RAPORTIMI PERIODIK
(6- mujor)**

PROKURORIA	
Gjashtë mujori i raportimit	
Drejtuesi i Prokurorisë (emër, mbiemër, e-mail, tel)	
Personi përgjegjës për përgatitjen e raportit (emër, mbiemër, e-mail, tel)	
Data e raportimit	

A. VOLUMI I PËRGJITHSHËM I ÇËSHTJEVE PËR PROKURORINË DHE ÇDO PROKUROR

Nr.	Prokurori	Nr. çështjeve të reja të regjistruara për periudhën e raportimit	Nr. çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme	Nr. total i çështjeve në hetim
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				

B. NUMRI I ÇËSHTJEVE PËR TË CILAT ËSHTË ZGJATUR AFATATI I HETIMIT SIPAS PARASHIKIMEVE TË NENIT 324, TË KODIT TË PROCEDURËS PENALE

Nr.	Prokurori	Numri i çështjeve për të cilat është regjistruar emri i personit që i atribuohet vepra penale dhe është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale			
		Nr. i hetimeve mbi 3 muaj	Nr. i hetimeve mbi 6 muaj	Nr. i hetimeve mbi 1 vit	Nr. i hetimeve deri në 2 vjet
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

C. RESPEKTIMI I ETIKËS DHE DISIPLINËS NGA PROKURORËT

Nr.	Prokurori	Përshkrim i rasteve për disiplinën e prokurorit	Përshkrim i rasteve për mosrespektimin e etikës nga prokurori
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			

D. NUMRI I KËRKESAVE DHE VENDIMEVE PËR PRANIM TË KËRKESAVE PËR HEQJE DORË

Nr.	Prokurori	Nr. i kërkesave për heqje dorë	Numri i vendimeve për pranim të kërkesave për heqje dorë
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			

E. NUMRI I KËRKESAVE DHE VENDIMEVE PËR PRANIM TË KËRKESAVE PËR ZËVENDËSIM TË PROKURORIT

Nr.	Prokurori	Nr. i kërkesave për zëvendësim prokurori	Numri i vendimeve për pranim të kërkesave për zëvendësim prokurori
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			

F. GJENDJEN E FUNKSIONIMIT DHE PËRDORIMIT TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË ÇËSHJTEVE SË BASHKU ME NEVOJAT E KONSTATUARA PËR PËRDITËSIMIN E KËTIJ SISTEMIT

Përshkrim i shkurtër mbi gjendjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve së bashku me nevojat e konstatuara për përditësimin e tij

G. NUMRI I KËRKESAVE DHE VENDIMEVE TË PRANUARA PËR ZGJATJEN E AFATIT TË PARABURGIMIT

Nr.	Prokurori	Numri i kërkesave për zgjatjen e afatit të paraburgimit	Numri i vendimeve për zgjatjen e afatit të paraburgimit
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			

H. NUMRI I RASTEVE TË SHTYRJEVE TË SEANCave GJYQËSORE PËR SHKAK TË MUNGESË SË PROKURORIT

Nr.	Prokurori	Numri i rasteve të shtyrjeve të seancave gjyqësore për shkak të mungesës së prokurorit
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		

I. PROBLEMATIKË TJETËR E EVIDENTUAR

Përshkruani çdo problematikë tjetër të evidentuar gjatë periudhës së raportimit që lidhet me veprimtarinë hetimore.